

Zhvillmi i një sistemi të sigurimit të cilësisë

Mark Mainwaring

Shqyrtimi i Cilësisë së Auditimit, FRC
Britania e Madhe

29 nëntor 2018



Financial Reporting Council

Welche Thiere gleichen ein-
ander am meisten?



Kaninchen und Ente.



Financial Reporting Council



Financial Reporting Council

Cila është lidhja?

- Çfarë shohim në të vërtetë?
- Audituesit mund të gënjehen
- Shembuj praktik



Informacion i përgjithshëm

Çfarë pamë herën e fundit
Duke parë pak më thellë:

- Shembuj real inspektimi
- Procedura në mbarë firmën
- Mbikëqyrja e OPK-ve
- Përzgjedhja e auditimeve
- Inspektorët e duhur



Çfarë pamë herën e fundit

- Themelet e kontrollit të cilësisë
- Çfarë duhet inspektuar
- Mbështetje ndërkombëtare



Shembuj

- Ofrimi i shërbimeve jashtë vendit
- Të ardhurat nga kontratat



Shembull 1

Provigjoni jashtë vendit

Grupi i inspektuar qe një shumëkombëshe me aktivitet në fushën minerare dhe ndërtim në mbarë botën (i quajtur në këtë shembull “ABC plc”). Çështja kishte të bënte me auditimin e një provigjoni mjedisor në një sipërmarrje të përbashkët jashtë shtetit. Firmat e auditimit të përmendura në rastin studimor nuk ishin përfshirë në auditim.

Qarkullimi i grupit ishte 31 miliard £, ndërsa materialiteti për auditimin qe caktuar 330 milion £.

Inspektimi KCA bëhej në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 30 qershor 2016.



Shembull 1

Quando është një sipërmarrje e përbashkët në pronësi të ABC dhe Ennercis, secila me kuotë pronësie 50%. Quando ka një minierë hekurnikeli në Amerikën e Jugut.

Në shkurt 2015, pësoi çarje një digë e minierës, me pasojë vërshimin e miliona ton ujë/mbetje minerare. Vdiqën 33 vetë, por pati edhe dëme të mëdha në mjedisin natyror dhe komunitetet lokale.

Kuota 50% që ka ABC në Quando kontabilizohet si pjesëmarrje në kapitalin neto. Më 30 qershor 2016, investimi i ABC-së në Quando u zhvlerësua në zero.

Në mars 2016, ABC, Quando dhe Ennercis ranë dakord me autoritetet vendore për të kompensuar dëmet e shkaktuara nga çarja e digës. Në marrëveshje thuhej se, nëse del nevoja, ABC dhe Ennercis do ta financonin Quando-n për të përmbushur detyrimet sipas Marrëveshjes.

Procedurat e auditimit për të vlerësuar ndikimin e çarjes së digës te pasqyrat financiare përqendrohej te vlerësimi i: Përshtatshmërisë së politikave përkatëse kontabël të ABC; Ekzistencës së çdo detyrimi ligjor ose konstruktiv; dhe Plotësisë së informacioneve shpjeguese në lidhje me detyrimet e kushtëzuara.

Ekipi auditues i Grupit pajtohej me administratorët e ABC-së se i vetmi provigjon i nevojshëm kishte të bënte me detyrimet e mundshme në zbatim të Marrëveshjes.

Më 30 qershor 2016, Quando llogariti koston e pritur të përmbushjes së detyrimeve sipas Marrëveshjes, me vlerë 2,4 miliardë \$, përfshirë një shumë fikse kompensimi dhe një kosto të përafërt rehabilitimi. Vlerësimi u auditua nga KPMG Argjentina si auditues komponenti për auditimin e Grupit ABC. Vlerësimi bazohej shumë në gjykim dhe KPMG raportoi theks mbi çështjen te EY duke theksuar pasigurinë.

Ekipi i auditimit i grupit angazhoi EY Brazil për të shqyrtuar mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e auditimit të KPMG. Nuk kishte informacion provues që ekipi i grupit t'i ketë dhënë udhëzime EY Brazil mbi objektin e shqyrtimit.

EY Brazil arriti në përfundimin se procedurat e auditimit të KPMG ishin të mjaftueshme (në një akt të shkurtër për ekipin e auditimit të Grupit). Ekipi i auditimit të Grupit bëri edhe një sërë thirrjesh drejtpërdrejt me KPMG-në. Nuk është mbajtur procesverbal për këto diskutime.



Shembull 1 – raporti faktik

Përcaktimi i shumës së një provigjioni bazohet shumë në gjykim dhe mund të jetë objekt paragjykimi të vetëdijshëm ose të pavetëdijshëm nga ana e administratorëve. Duke pasur parasysh riskun e dukshëm të identifikuar, ekipi i grupit duhet të ushtrojë mbikëqyrje rigoroze dhe të detajuar të punës së ekipit të komponentit ose të kryejë vetë procedurat për të vlerësuar përshtatshmërinë e shumës së parashikuar si provigjion.

Ekipi i Grupit mori dëshmi të pamjaftueshme për të mbështetur koston e parashikuar të rehabilitimit dhe, rrjedhimisht, provigjionin e Quandos për një detyrim të mundshëm financimi. Në veçanti ekipi i Grupit:

- Nuk mori raportim të detajuar mjaftueshëm nga KPMG për të vlerësuar supozimet kryesore të përdorura nga Quando në parashikimet e flukseve monetare ose për të vlerësuar cilësinë e dëshmive të marra nga KPMG;
- Nuk i dha udhëzime EY Brazil për të siguruar që shqyrtimi i procedurave të kryera nga KPMG të ishte i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm. Përveç kësaj, raportimi i EY Brazil ishte në nivel tepër të lartë në lidhje me përshtatshmërinë e provigjionit të parashikuar; ose
- Nuk kreu testim të përshtatshme të sistemit të kontrollit të brendshëm të ABC mbi procesin e çmuarjes së kostove, ose çmuarjet e flukseve monetare bazë dhe supozimet e përdorura për të matur koston e pritur të punimeve rehabilituese.



Shembull 2

Kontratë me humbje

Shoqëria ofron zgjidhje telekomunikacioni, përfshirë instalimin e softuerit me porosi, dhe ka kontabilizuar të ardhura prej 331 milionë sterlina. Ekipi i auditimit ndoqi një qasje auditimi të plotë, përfshirë përdorimin e CAAT-ve të të ardhurave.

Materialiteti për efekt auditimi qe 1,9 milion sterlina.

Inspektimi KCA bëhej në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 mars 2017.

Shembull 2

Kontratë me humbje – RDG

Kontratat RDG përfshinin elementë të shumëfishtë me vlerë totale prej 9,7 milionë sterlina për pesë vjet (të ardhurat nga viti financiar 2017 prej 3,4 milionë sterlina). Ndodhën vonesa të konsiderueshme dhe kosto të papritura dhe RDG kërkoi rishikime të konsiderueshme të kontratës në nëntor 2016. Administratorët çmonin se nevojitej një provigjion shtesë prej 1 milion £. Kjo i çonte humbjet totale për këto kontrata për atë vit në 3,6 milionë £.

RDG kërkoi që rishikimet e kontratës të përfundonin brenda muajit mars 2017.

Ekipi i auditimit pyeti personelin kryesor që administrojnë kontratën RDG, përfshirë menaxherin e projektit dhe drejtorin e projekteve. Ekipi i auditimit mori kopje të parashikimeve të përdorura për të llogaritur provigjionet e humbjeve nga ekipi i projektit dhe diskutoi me hollësi për të kuptuar procesin e kryer për të nxjerrë parashikimet dhe statusin e projektit.

Ekipi i auditimit konfirmoi normat e përdorura për një kampion të punonjësve dhe sipërmarrësve në parashikimet e përgatitura dhe krahasoi orët faktike të realizuara në prill 2017 me parashikimet. Për diferencat u morën shpjegime.

Ndryshimi i kërkuar i planeve të kontratës nuk ishte dorëzuar në datën e raportit të auditimit (qershor 2017).



Shembull 2 – raporti faktik

Ekipi i auditimit nuk ka marrë dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme lidhur me plotësinë e kostove të parashikuara për kryerjen e kontratës RDG. Në veçanti, ekipi i auditimit nuk ka marrë dëshmi të jashtme mbështetëse, siç janë kopjet e korrespondencës midis shoqërisë dhe RDG lidhur me progresin dhe statusin e kontratës.

Përveç kësaj, ekipi i auditimit nuk ka evidentuar mjaftueshëm: Nivelin e detajuar të diskutimeve të zhvilluara me ekipin e projektit dhe drejtuesit e tjerë kyç; Se si procedurat e kryera kanë sjellë siguri të mjaftueshme se parashikimet për produktet e mbetura të kontratës qenë të arsyeshme; dhe Shqyrtimin që kanë bërë nëse vonesa në sigurimin e piketave të rishikuara dhe planeve të projekteve ka pasur rrjedhoja për plotësinë e kostove të parashikuara deri në përfundim.



Mësimet e nxjerra

- **Shembulli 1**
 - Pikënisja në vendin e gabuar
 - Mbikëqyrja e duhur
 - Mbështetja e gjykimeve
- **Shembulli 2**
 - Rreziqet e familjaritetit
 - Auditimi me diskutim
 - Logjika e thjeshtë



Procedura në mbarë firmën

- ISQC 1
- Çfarë vlerësojmë...
 - Toni nga lart
 - Etika dhe pavarësia
 - Kontrolli i cilësisë
 - Vlerësimet e partnerëve
 - Pranimi i klientit



Shqyrtimet tematike

- Shqyrtim me gamë të gjerë në mbarë firmat
- Raportet e kohëve të fundit:
 - Materialiteti
 - Analiza e shkaqeve në rrënjë të problemit
 - Planifikimi
 - Analitika e të dhënave
- Krahasimi në mbarë firmat



Mbikëqyrja e OPK-ve

- Mbikëqyrja e organeve profesionale nga FRC:
 - Edukimi dhe trajnimi
 - Monitorimi i auditimit
 - Zbatimi me forcë

Bërja e përzgjedhjes së duhur

- Faktorët që duhen mbajtur parasysh:
 - E listuar?
 - Ndryshimi i firmës së auditimit?
 - Paralajmërimet për fitimin?
 - Inspektimet të mëparshme të dobëta?
 - Mbulim i dobët në media?



Fushat e duhura të auditimit

- Vështirë për t'u audituar?
 - Fushat e gjykimit
- Material?
- Fushë problematike e përsëritur?
- Specifik për një sektor ekonomik?





Financial Reporting Council



Financial Reporting Council